




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, ee.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në pajtim me nenin 4 paragrafi 2 pika 2.4 dhe 3.1 si dhe paragrafi 3.pika 3.3.1 të Ligjit për Shpronësimet e pronës së paluajtshme nr. 03/L – 139 , nenit 11 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 , nenit 38 pika c. neni 39.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 27.04.2011, miraton këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMERIVE PËR RREGULLIMIN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE NË KOMUNËN E GJILANIT

- I. Shpallet interesi publik për shpronësimin e paluajtshmërive për rregullimin e infrastrukturës rrugore në Gjilan sipas ketyre projekteve në vijim
- II. Rruga “ Hasan Remniku “ me gjatësi 2200 m² duke filluar nga aksi rrugor afër pompës së benzinës “ Kosova Petroll” ,dhe vazhdon në drejtim të fshatit Livoq i Ulët dhe lidhet me rrugën për në fshatin Cërnice. Kjo rrugë i përshkon gjithsejt 94 ngastra kadastrale të cilat ndahen në dy zona kadastrale , të Gjilanit dhe të Livoqit të Ulët.
- III. Rruga “Jugu I” Pjesa e Dytë , e cila fillon nga fabrika e Radiatorëve dhe lidhet me rrugën Gjilan - Preshevë , afër ndërmarjes “Çeliku 2” , e cila përshkon 8 ngastra kadastrale, në ZK. Gjilan , me sipërfaqe të tërsishme të shpronësuar prej 4506 m² (0.45.06 ha).
- IV. Rruga “Dardania I” e cila lidhet me Rrugën Qarkore, e ashtuquajtura “ Lovca City “ , e cila përshkon 9 ngastra kadastrale me ZK. Gjilan dhe 4 ngastra kadastrale ZK. Koretishtë, KK. Novobërdë.
- V. Rruga Qarkore - Rruga ekzistuese e cila fillon nga aksi rrugor i magjistrales Gjilan-Bujanoc (përballë fabrikës së Bativerive) dhe përfundon në aksin rrugor i cili lidhet me magjistralen Gjilan - Ferizaj (përballë Kolegjit “ Gjilani “) me gjatësi rreth 7 km, dhe i përshkon 316 ngastra kadastrale të cilat janë të ndara në ZK.Gjilan , ZK. Shillovë, ZK. Livoq i Ulët dhe ZK. Koretishtë ,KK. Novobërdë.
- VI. Pjesë e këtij vendimi do të jetë regjistri i pronave për shpronësim i paraqitur me elaboratet për shpronësim.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë, Pronës dhe Banimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Zyra e Projekteve dhe organet tjera për aq sa ndikohen me këtë vendim, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani.
- VIII. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit nga ana e KK-së në Gjilan.

01.Nr. 16/5760
Gjilan, më 27.04.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues